




		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dop.	Dop.	Nr. Prot.	06-02/3416/22
Dop.	Dop.	Bz. Prot.	
Nr. Ifaq.	Broj stranica	Prot No.	
	02	Date	
		Datum	16.08.2022
		Date	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 10.08.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbylllet rasti AKK-DPKI-06-2615/21, për zyrtaren e lartë znj. Mimoza Kusari - Lila, Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se ështëshmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Mimoza Kusari - Lila, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se znj. Mimoza Kusari - Lila, krahas ushtrimit të funksionit publik Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, është edhe përfaqësuese e autorizuar përkatësisht mban funksion drejtues (Drejtor Ekzekutiv) në OJQ "StayIn".

Fillimisht, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me qëllim të verifikimit të gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, ka kërkuar informatat për OJQ-në në fjalë nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nga përgjigja e pranuar prej Departamentit për OJQ (shkresa zyrtare: DPKI-06-2615/21), zyrtarja në fjalë figuron të jetë përfaqësues i autorizuar - drejtor ekzekutiv i OJQ-së si më lart.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-02/2445/22, e ka njoftuar zyrtaren e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, znj. Mimoza Kusari - Lila është njoftuar lidhur me faktet për rastin e saj, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionin publik.



Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në organizata joqeveritare, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se: “*Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë private, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritet tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni*”.

Ndërsa me nenin 14 paragrafi 1, të LPKI-së, është përcaktuar se: “*Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to*”.

Zyrtarja e lartë znj. Mimoza Kusari - Lila, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se kjo OJQ është jofunksionale për më tepër se pesëmbëdhjetë vite, si dhe ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.


Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatën të cilën më pas e ka konfirmuar nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme (DPKI-06-02/2445-01/22), se zyrtarja e lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme, duke u tërhequr nga pozita e përfaqësuesit të autorizuar - drejtor ekzekutiv e OJQ-së në fjalë.

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtarja e lartë znj. Mimoza Kusari - Lila është tërhequr nga funksioni në OJQ, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtarja e lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:



Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korruptionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)